

Muhamed Mursi, presidenti i parë i Egjiptit i zgjedhur në mënyrë demokratike i cili ndërroi jetë dy ditë më parë, nuk vdiq nga shkaqe natyrore, por u vra, tha presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdo?an, raporton Anadolu Agency (AA).

"Muhamed Mursi fatkeqësisht u përpëliti për 20 minuta në dyshtim të gjykatës dhe zyrtarët aty nuk ndërhyrën. Ja, unë them se ai nuk vdiq nga shkaqe natyrore, por u vra", theksoi Erdo?an në një ceremoni inaugurimi në Stamboll.

Presidenti turk deklaroi se përkundër testamentit të tij për t'u varrosur në fshatin e lindjes, autoritetet nuk ia dorëzuan familjes kufomën për ta realizuar një gjë të tillë.

"Ata u frikuan madje edhe nga kufoma e tij", theksoi Erdo?ani.

Ai po ashtu potencoi se Turqia do të vihet në veprim në mënyrë që Egjipti të gjykohej në organet ndërkombëtare gjyqësore për trajtimin ndaj Mursit.

"Ne do të bëjmë çdo gjë të nevojshme që Egjipti të gjykohej në gjykatat ndërkombëtare", tha Erdo?an.

"Gjithashtu, ftojme Organizatën e Bashkëpunimit Islam të kryejë detyrën e saj. Është kusht që ajo të bëjë punën e nevojshme", tha më tej presidenti i Turqisë, duke shtuar se Turqia do ta aktualizojë këtë çështje edhe në takimin e G20-tës në Osaka të Japonisë në fund të këtij muaji.

Ndryshe, 67-vjeçari Mursi humbi jetën dy ditë më parë në një seancë gjyqësore në të cilën përballej me një sërë akuzash që kur u rrëzua dhe u burgos pas puçit ushtarak në vitin 2013.

Mediat raportuan se ai është lënë i rrëzuar në dyshtim për 20 minuta pasi humbi ndjenjat gjatë gjyqimit.

Mursi kishte paralajmëruar më herët për përkeqësimin e gjendjes së tij shëndetësore, por autoritetet kishin injoruar ankesën e tij.

Aktivistë për të drejtat e njeriut dhe familja e tij gjithashtu janë shprehur se Morsi nuk ka marrë trajtim për problemet shëndetësore gjatë kohës në burg.

Ish-presidenti i Egjiptit i zgjedhur me votë u varros në lindje të Kajros në orët e hershme të mëngjesit të djeshëm nën masa të forta të sigurisë dhe në prani vetëm të anëtarëve të familjes së tij dhe avokatëve.

Mursi, si anëtar kryesor i Vëllazërisë Muslimane të Egjiptit, në vitin 2012 fitoi zgjedhjet e para të lira presidenciale në Egjipt. Pas vetëm një viti në detyrë, ai u rrëzua dhe u burgos me një grusht shteti të përgjakshëm ushtarak të udhëhequr nga ministri i atëhershëm i Mbrojtjes dhe presidenti aktual, Abdel Fattah al-Sisi.

Mursi u dënua me 48 vjet burgim gjithsej në katër nga gjykimet e hapura kundër tij, ndërkohë që vazhdonte procesi i gjyqimit në dy raste të tjera.